# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 46

**Tiranë – E martë, 21 mars 2023**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr. 17/2023, datë 16.2.2023 | Për miratimin e kontratës shtesë për ndryshimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive "Sicpa *Security Solutions"* SA e "Sicpa *Security Solutions Albania"* sh.p.k. për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave, miratuar me ligjin nr. 10381, datë 24.2.2011 | 4987 |
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 16.2.2023 | Me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për çështjen administrative nr. 31116-05015-86-2017, të regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 4.10.2017, dhe përshpejtimi i procedurave për shqyrtimin e saj.<br>Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për çështjen gjyqësore të regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 15 regjistri dhe shfuqizimi i vendimit 15, datë 27.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.<br>Urdhërimin e Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar brenda 3 muajve çështjen gjyqësore nr. 31116-05015-86-2017, të regjistruar më 4.10.2017 në këtë gjykatë..... | 4989 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 10, datë 3.3.2023 | Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a... | 5001 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 11, datë 3.3.2023 | Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Berat sh.a. | 5003 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 12, datë 3.3.2023 | Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a..... | 5004 |

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 13, datë 3.3.2023

Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 431, datë 11.11.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Shkodër"..... 5005

**LIGJ**
**Nr. 17/2023**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SHTESË PËR NDRYSHIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE SHOQËRIVE "SICPA *SECURITY SOLUTIONS"* SA E "SICPA *SECURITY SOLUTIONS ALBANIA"* SHPK PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, DIZENJIMIN, PRODHIMIN DHE NGRITJEN E NJË SISTEMI PËR EMETIMIN, SHPËRNDARJEN, GJETJEN DHE MONITORIMIN E PULLAVE FISKALE E TË PULLAVE TË KONTROLLIT TË BARNAVE, MIRATUAR ME LIGJIN NR. 10381, DATË 24.2.2011**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI

Neni 1

Miratohet kontrata shtesë për ndryshimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive "SICPA *Security Solutions*" SA e "SICPA *Security Solutions Albania*" sh.p.k. për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave, miratuar me ligjin nr. 10 381, datë 24.2.2011, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE
**Ermonela Felaj (Valikaj)**

Miratuar në datën 16.2.2023.

Prot. No. ALB.GM-23-004

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë**
**Dhe "SICPA *Security Solutions Albania"* sh.p.k., dhe**
**SICPA SA**

**KONTRATË SHTESË**
PËR NDRYSHIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE SHOQËRIVE "SICPA *SECURITY SOLUTIONS* S.A." E "SICPA *SECURITY SOLUTIONS ALBANIA"* SHPK, PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, DIZENJIMIN, PRODHIMIN DHE NGRITJEN E NJË SISTEMI PËR EMETIMIN, SHPËRNDARJEN, GJETJEN DHE MONITORIMIN E PULLAVE FISKALE E TË PULLAVE TË KONTROLLIT TË BARNAVE,
TË MIRATUAR ME LIGJIN NR. 10381, DATË 24.2.2011

Kjo kontratë shtesë nënshkruhet sot, më 24.1.2023, në Tiranë, Shqipëri ndërmjet:

1. Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë te Republikës së Shqipërisë (më poshtë referuar si "Autoriteti", bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë, Shqipëri, në emër të Republikës së Shqipërisë,

2. "SICPA *Security Solutions Albania"* sh.p.k. (më poshtë referuar si "SICPA Albania"), një shoqëri shqiptare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër L02120032R, me seli qendrore në rrugën "Gryka e Kaçanikut", autostrada Tiranë–Durrës, km 5, kati 4, Tiranë, Shqipëri; dhe

3. SICPA SA (më poshtë e referuar si "Mëma"), një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit Zviceran, me seli në 41 Avenue de Flonssant, 1008 Priliy, Zvicër.

Secila një "Palë" dhe së bashku "Palët.

Ku:

A. Palët kanë lidhur një Kontratë Koncesioni mbi Krijimin dhe Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Pullave Fiskale të miratuar nga Parlamenti Shqiptar, me ligjin nr. 10381, datë 24.2.2011, ("Kontrata e Koncesionit"); dhe

B. Palët kanë rënë dakord për të bërë disa ndryshime në Kontratën e Koncesionit.

PIKA 1 – NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT

a) Neni 3.2 i Kontratës së Koncesionit do të ndryshohet, si më poshtë:

"3.2 Koncesioni jepet për një periudhë që fillon në Datën Efektive dhe mbaron më 31 dhjetor 2024 ("Afati"); me kusht që, nëse kjo Kontratë përfundon më shpejt, sipas kushteve të saj, "Afati" do të nënkuptojë dhe do të kufizohet në periudhën që fillon në Datën Efektive dhe mbaron në datën e përfundimit të kësaj Kontrate, në përputhje me termat e saj.".

b) Palët bien dakord se çmimeve për njësi të produkteve të referuara në pikën 17.1 të Kontratës së Koncesionit do t'u aplikohet një zbritje prej 10%, duke filluar nga data 7.2.2023.

c) Në aneksin 1 të Kontratës së Koncesionit bëhen ndryshimet, si vijon:

"a) "Produkte/t quhen produktet e duhanit, produktet e distiluara dhe të fermentuara të alkoolit, duke përfshirë birrën dhe produkte të tjera që i shtohen qëllimit të shërbimeve kohë pas kohe, në përputhje me nenin 3.6 të kësaj Kontrate;

b) Fshihet çdo referencë e bërë lidhur me 'Produktet Farmaceutike'.".

d) Çdo përcaktim apo referencë tjetër në Kontratën e Koncesionit për Produktet Farmaceutike fshihet.

PIKA 2 – DETYRIME E ANGAZHIME TË TJERA MES PALËVE

a) Palët deklarojnë se heqin dorë në mënyrë të parevokueshme nga çdo pretendim apo kërkesë lidhur me Produktet Farmaceutike, bazuar në Kontratën e Koncesionit.

SICPA Albania dhe Mëma deklarojnë se nuk kanë shfaqur apo pretenduar dhe nuk do të kenë në të ardhmen asnjë pretendim apo kërkesë ndaj Autoritetit për zbatimin e produkteve të tjera objekt i Kontratës së Koncesionit të miratuar me ligjin nr. 10381, datë 24.2.2011.

b) SICPA Albania dhe Mëma angazhohen për vazhdimin e teknologjisë aktualisht të implementuar, bazuar në Kontratën e Koncesionit, me disa përmirësime teknologjike në fushat e gjykuara si të detyrueshme për funksionalizimin e duhur të saj në thelbin operacional dhe në terren e, konkretisht, duke realizuar:

(a) Përmirësime të caktuara, nëse janë të nevojshme, të platformës ekzistuese CAPEX i kufizuar, për të lejuar funksionalizimin dhe operimin e efektshëm të teknologjisë/sistemit aktual.

(b) Nisjen e modulit të ri të raportimit të Shërbimeve të të Dhënave që i mundëson Autoritetit më shumë analitikë përshkruese, duke u fokusuar në atë që ndodhi në të kaluarën, analitike diagnostike, që ndihmon në zbulimin e arsyes, se pse ndodhën gjërat dhe analitikë parashikuese që mundësojnë parashikimin e asaj që ka të ngjarë të ndodhë në të ardhmen – aktivizimi + integrimi në platformën ekzistuese.

(c) Asistencë teknike tek Autoriteti me të gjithë ekspertizën teknologjike dhe operacionale të ekspertëve të Mëmës për vijueshmërinë dhe funksionimin e sistemit të pullave fiskale, 7 muaj para përfundimit të afatit.

c) Palët angazhohen të punojnë së bashku të zbatojnë aktivizimin digjital të pullave fiskale, në momentin që paguhen detyrimet e akcizës bazuar në Procedurën e Ndryshimit të Kontrollit të përcaktuar në aneksin 16 të Kontratës së Koncesionit. Kërkesa përkatëse për ndryshim do të bëhet nga Autoriteti jo më vonë se 10 ditë pas nënshkrimit të kësaj Kontrate Shtesë. Afatet e zbatimit do të përcaktohen brenda vlerësimit të impaktit, sipas nenit 7, të aneksit 16, dhe mund të ndryshojë sipas produktit.

PIKA 3 – TË PËRGJITHSHME

Kjo kontratë shtesë hyn në fuqi në datën e hyrjes në fuqi te ligjit që miraton këtë Kontratë.

Në dëshmi të nënshkrimit të kësaj Kontrate Shtesë rregullisht nga Palët

Nënshkroi për dhe në emër të
Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
të Republikës së Shqipërisë
Nënshkrimi _____
Emri: Delina Ibrahimaj
Pozicioni: Ministre e Financave dhe
Ekonomisë (Autoriteti)

Nënshkroi për dhe në emër të
"SICPA *Security Solutions Albania*" sh.p.k.
Nënshkrimi_____
Emri: Samir Shqarri
Roli: Administrator

Nënshkroi për dhe në emër të
SICPA SA
Nënshkrimi _____
Emri: Rilind Bytyqi
Roli: Përfaqësues me prokurë

**VENDIM**
**Nr. 6, datë 16.2.2023**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Marsida Xhaferllari kryesuese;
Fiona Papajorgji anëtare;
Sonila Bejtja anëtare;
Sandër Beci anëtar;
Ilir Toska anëtar;
Genti Ibrahimi anëtar;
Marjana Semini anëtare;
Elsa Toska anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 19.1.2023 dhe 16.2.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 13 (A) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Agron Bajri

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit,
Bashkia Tiranë

Policia Bashkiake, Tiranë

Rakip Shehu

Fitim Çollaku

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm për çështjen administrative nr. 31116-05015-86-2017, të regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 4.10.2017, dhe përshpejtimi i procedurave për shqyrtimin e saj.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm për çështjen gjyqësore të regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 15 regjistri dhe shfuqizimi i vendimit 15, datë 27.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Urdhërimi i Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar brenda 3 muajve çështjen gjyqësore nr. 31116-05015-86-2017 të regjistruar më 4.10.2017 në këtë gjykatë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 399/1–399/12 të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*; nenet 27 dhe 71 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, shpjegimet e subjekteve të interesuara, Policia Bashkiake, Tiranë dhe Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë *(IMT, Tiranë)*, që nuk kanë mbajtur qëndrim për kërkesën, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjekteve të interesuara Rakip Shehu *(R.Sh.)* dhe Fitim Çollaku *(F.Ç.)*, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
**Rrethanat e çështjes**

1. Në datën 3.4.2017 kërkuesi i është drejtuar IMT-së, Tiranë dhe Policisë Bashkiake, Tiranë me kërkesë për heqjen e rrethimit të bërë nga shtetasit R.SH. dhe F.Ç. në pronën e tij.

2. Në përgjigje të kërkesës së tij, me shkresën nr. A – 8536/ 1 prot., datë 5.5.2017, IMT-ja, Tiranë e ka informuar se pas inspektimeve të kryera në zonën në fjalë nuk ka konstatuar punime në proces. Sipas këtij institucioni, gjendja e objekteve, pronave e rrethimeve është e njëjta prej vitesh dhe se pas verifikimeve të kryera ka rezultuar se konflikti i pronësisë është i hershëm dhe në sipërfaqe të caktuara ka mbivendosje prone. Në këto kushte, ajo nuk mund të zgjidhë konfliktin mes palëve.

3. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi kundër IMT-së, Tiranë dhe Policisë Bashkiake, Tiranë me objekt: *"Detyrimin e organit publik të kryejë një veprim administrativ që është refuzuar apo për të cilin organi publik ka heshtur ndonëse ka pasur kërkesë. Prishja e rrethimit të paligjshëm (me tel) që është bërë nga ana e shtetasve Rakip Shehu dhe Fitim Çollaku në pronën e shtetasit Agron Tahir Bajri në pasurinë me nr. 1/522, të ndodhur në zonën kadastrale 8210, vol. 28, faqe 238, me sipërfaqe 140 m², me adresë ish-fusha e aviacionit civil, Tiranë."*.

4. Me vendimin nr. 3319 (3380), datë 26.7.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: *"Pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e palës së paditur IMT e Bashkisë Tiranë që të ndërhyjë për prishjen e rrethimeve të paligjshme të bëra në pasurinë nr. 1/522, të ndodhur në zonën kadastrale 8210, të regjistruar në ZVRPP Tiranë në vol. 28, f. 238, me sipërfaqe 140 m², me pronar Agron Bajri."*.

5. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim pala e paditur, Bashkia Tiranë. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 4.10.2017 me nr. 31116-05015-86-2017 regjistri themeltar dhe, pas ndjekjes së procedurave të shortit, i ka rënë për shqyrtim gjyqtares A.N.

6. Në kushtet kur çështja nuk ishte shqyrtuar ende nga Gjykata Administrative e Apelit, në datën 7.2.2022 kërkuesi i është drejtuar Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit dhe përshpejtimin e procedurave.

7. Pas kërkesës për informacion në lidhje me fazën e gjykimit të çështjes, sipas nenit 399/4, pika 1, të KPC-së, me shkresën nr. 501/1 prot., datë 6.4.2022, gjyqtarja relatore në Gjykatën Administrative të Apelit ka informuar Gjykatën e Lartë se çështja në fjalë është regjistruar në datën 4.10.2017 dhe se ajo është caktuar si relatore me shortin elektronik të datës 6.10.2017. Sipas gjyqtares, për shkak të volumit tepër të madh të çështjeve të regjistruara për gjykim në atë gjykatë, ngarkesës së madhe të krijuar për shkak të rishortimit të çështjeve të planifikuara dhe në proces gjykimi nga gjyqtarët e shkarkuar nga detyra në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve sipas ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kalendarit të shqyrtimit të çështjeve, sipas të cilit ende po shqyrtohen çështje të vitit 2016, numrit të kufizuar të gjyqtarëve në gjykatë, kohës së ardhjes së dosjes dhe radhës së regjistrimit të saj në Gjykatën Administrative të Apelit, çështja nuk është planifikuar ende për gjykim *(shih vendimin nr. 15, datë 27.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, faqja 2, paragrafi 8)*.

8. Në vijim, me vendimin nr. 15, datë 27.5.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave.

9. Në datën 23.6.2022 kërkuesi i është drejtuar fillimisht Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të themelit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit dhe përshpejtimin e shqyrtimit të saj nga ajo gjykatë, si dhe konstatimin e cenimit së kësaj të drejte edhe nga Gjykata e Lartë, duke pretenduar mungesën e vendimmarrjes së kësaj të fundit për kërkesën e tij për përshpejtim.

10. Në vijim, në datën 31.8.2022, kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë, duke kërkuar edhe shfuqizimin e vendimit nr. 15, datë 27.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

11. Në datën 23.9.2022 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve të kërkesës së datës 23.6.2022, ndërsa në datën 12.10.2022 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Po kështu, në datën 11.11.2022, Kolegji tjetër i Gjykatës ka vendosur kalimin për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve të çështjes së kërkuesit që i përket kërkesës së datës 31.8.2022.

12. Në datën 16.11.2022 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur bashkimin e çështjeve në një të vetme, me nr. 13 (A) 2022 të Regjistrit Themeltar.

13. Në seancën e datës 19.1.2023, bazuar në nenin 44/a të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës, duke e vlerësuar të nevojshme marrjen e informacionit nga Gjykata Administrative të Apelit për periudhat e shqyrtimit të çështjeve prej saj, duke iu referuar ngarkesës së gjykatës, gjyqtarëve relatorë, ose muajve përkatës të ngarkesës për secilin gjyqtar relator. Në

informacionin e përcjellë, Gjykata Administrative e Apelit ka informuar Gjykatën edhe se çështja e kërkuesit ishte planifikuar për t'u shqyrtuar në dhomë këshillimi në datën 1.2.2023. Në vijim, ajo ka informuar Gjykatën se me vendimin e datës 1.2.2022 është vendosur kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me tjetër trup gjykues.

14. Pas zhvillimit të seancës plenare të datës 19.1.2023, përbërja e trupit gjykues të Gjykatës ka ndryshuar, si rrjedhojë e zëvendësimit të një gjyqtari, të cilit i kishte mbaruar mandati, me një gjyqtar të ri. Në kushtet kur në seancën e datës 19.1.2023 gjykimi i çështjes kishte filluar, gjyqtari i ri i emëruar nuk ka marrë pjesë në seancën e datës 16.2.2023.

II

**Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese**

**15.** ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i janë cenuar:

*15.1 E drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

15.1.1 *Standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*, si rrjedhojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë. Sipas tij, çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 4.10.2017 dhe për të nuk ka ende një vendimmarrje, pavarësisht se kanë kaluar mbi 5 vjet, në shkelje të nenit 48, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012)* dhe nenit 399/2, pika 1, shkronja "a", të KPC-së. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vendosur për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave pas 4 muajve, në shkelje të afatit 45-ditor të parashikuar nga neni 399/7, pika 2, i KPC-së.

15.1.2 *Standardit të arsyetimit të vendimit,* pasi Gjykata e Lartë ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave bazuar vetëm në ngarkesën e punës së gjyqtarit relator, pavarësisht se ka konstatuar tejkalimin e afateve të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit. Ajo nuk ka mbajtur parasysh qëndrimin e Gjykatës se ngarkesa e gjykatave nuk përbën argument kushtetues që justifikon vonesën në gjykim, ndërkohë që ka vendosur në themel të vendimmarrjes kritere të reja, të paparashikuara në Kushtetutë, ligj ose KEDNJ, të tilla si: "ngarkesa totale individuale e gjyqtarit relator", "problematika e përgjithshme që tejkalon rastin konkret", si dhe "kosto që natyrshëm reforma në drejtësi ka krijuar për qytetarët". Gjykata e Lartë ka përvetësuar tagra të pushtetit ligjvënës mbi qëllimin e miratimit të neneve 399/1–399/12 të KPC-së, duke ligjëruar dhe kthyer në standard arsyetimin se çdo vonesë, e shkaktuar si rrjedhojë e reformës në drejtësi, nuk përbën shkelje të afatit të arsyeshëm, por shkak objektiv të njohur dhe mbrojtur nga ligji. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë është jologjik për sa u përket rrethanave të faktit dhe cilësimit që KPC-ja u jep këtyre rrethanave, inkoherent dhe i paarsyetuar në kuptimin kushtetues. Ajo ka mbivlerësuar anën formale dhe shkresore që ka çuar në zvarritjen e çështjes, pavarësisht se është tejkaluar mbi 60 herë afati ligjor për gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit dhe 5 herë afati i arsyeshëm i parashikuar në nenin 399/2 të KPC-së.

*15.2 E drejta për mjete ligjore efektive.* Nenet 399/1–399/12 të KPC-së nuk kanë gjetur zbatim efektiv në praktikë, pasi janë interpretuar në mënyrë antikushtetuese nga Gjykata e Lartë.

*15.3 E drejta e pronës*, në drejtim të gëzimit, posedimit dhe disponimit të saj, si rrjedhojë e mosgjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit brenda afatit ligjor. Gjykata e Lartë nuk ka analizuar rrethanat e çështjes në drejtim të cenimit të së drejtës kushtetuese të pronës. Në kërkesëpadinë objekt gjykimi ai ka kërkuar detyrimin e organit publik, veprimtaria e të cilit është ruajtja dhe disiplinimi i ndërtimeve në kuadër të mbrojtjes së territorit, për të ushtruar përgjegjësinë e tij dhe për të ndërhyrë në mbrojtje të së drejtës së pronësisë. Interesi i tij në mbrojtjen e kësaj të drejte vazhdon, pasi prona vijon të jetë e rrethuar nga persona jopronarë.

**16.** ***Subjekti i interesuar***, Policia Bashkiake, Tiranë, nuk ka mbajtur qëndrim për objektin e kërkesës. Ajo ka parashtruar se nuk ka kompetenca ligjore dhe nuk disponon specialistë për verifikimin e statusit juridik dhe hartografik të hapësirës ose zgjidhjen e konflikteve të pronës private mes kërkuesit dhe shtetasve R.SH. e F.Ç. Ajo ka njoftuar punonjësit e IMT-së për ndjekjen e

procedurave ligjore, pasi marrja e masave dhe kryerja e procedurave përkatëse për vlerësimin e punimeve nuk është objekt i punës së saj.

**17. *Subjekti i interesuar*,** IMT-ja, Tiranë, nuk ka mbajtur qëndrim për objektin e kërkesës, duke parashtruar se çështja e kërkuesit nuk hyn në kompetencat e saj lëndore dhe se gjatë inspektimit të kryer në terren nuk janë konstatuar punime ndërtimore në proces për ndërmarrjen prej saj të veprimeve konform ligjit.

**18. *Subjektet e interesuara*,** R.SH. dhe F.Ç., nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III
**Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese**

*A. Për legjitimimin e kërkuesit*

19. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

20. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi, në thelb, pretendon gjykimin përtej afatit të arsyeshëm të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, duke kërkuar edhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që ka rrëzuar kërkesën e tij për përshpejtimin e procedurave.

21. Si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuesi legjitimohet *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

22. Gjykata vëren, gjithashtu, se në parashtrimet e tij kërkuesi ka pretenduar se: Policia Bashkiake, Tiranë nuk është palë në proces dhe, për rrjedhojë, nuk ka interes të ligjshëm në çështjen objekt gjykimi; nuk ekziston një lidhje mes kërkimit të tij dhe përgjigjes së ardhur për çështjen nga ky institucion; gjykimi kushtetues nuk mund të jetë i ndërvarur nga qëndrime, gjykime ose veprime të organeve qendrore ose vendore, aq më tepër kur ato nuk janë organe kushtetuese dhe janë bërë shkak për zvarritjen e çështjes; nuk ka një parashikim ligjor përmes të cilit Gjykata të përdorë mjete ekstraprocedurale për ndërmjetësimin me organe të ndryshme publike ose të kërkojë jashtëgjyqësisht ekzekutimin e objektit të padisë për kërkimin e tij; nuk ka kërkuar ndërmjetësim për zgjidhjen e çështjes, por kontrollin kushtetues të veprimeve ose mosveprimeve të gjykatave të zakonshme, në drejtim të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

23. Gjykata rithekson se sipas nenit 39 të ligjit nr. 8577/2000, pjesëmarrës në gjykimin kushtetues janë: a) subjekti që ka paraqitur kërkesën ose përfaqësuesi i tij; b) subjektet kundër të cilave është paraqitur kërkesa ose që kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet; c) organi që ka nxjerrë aktin; ç) organet shtetërore që janë në mosmarrëveshje për kompetencë. Vlerësimi i legjitimimit të subjektit të interesuar bazohet jo vetëm në interes të subjektit, por edhe të gjykimit kushtetues dhe, në këtë kuptim, në gjykimet kushtetuese legjitimohen si subjekte të interesuara ato që, për shkak të veprimtarisë ose rrethanave, mund të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, pavarësisht nëse thirren në gjykim me kërkesën e kërkuesit ose dhe kryesisht nga Gjykata *(shih vendimet nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 9, datë 23.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese).*

24. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Policia Bashkiake, Tiranë ka qenë palë në procesin gjyqësor objekt kundërshtimi në Gjykatë, ndaj dhe, si e tillë, ajo legjitimohet si palë në rastin konkret, në kuptim të nenit 39, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000.

25. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike *efektive*, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur *(shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, 'Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar" (*ligji nr. 38/2017*), Gjykata ka vlerësuar se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e së drejtës kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe se individi duhet t'i shfrytëzojë ato përpara se t'i drejtohet asaj *(shih vendimin nr. 3, datë 11.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*. Megjithatë, duke qenë këto mjete të reja, si dhe duke pasur parasysh qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)* për çështje të kësaj natyre, Gjykata e ka konsideruar të shteruar këtë kriter si në rastet kur Gjykata e Lartë është shprehur me vendim *(shih vendimet nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*, ashtu edhe në rastet e mungesës së një vendimi të saj *(shih vendimet nr. 39, datë 9.12.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

27. Në rastin konkret, kërkuesi ka pretenduar se i është drejtuar disa herë Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për përshpejtimin e gjykimit dhe, në kushtet e mungesës së një vendimmarrjeje të asaj gjykate për çështjen e tij, i është drejtuar Gjykatës së Lartë në përputhje me nenet 399/1 e vijuese të KPC-së.

28. Me vendimin nr. 15, datë 27.5.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, duke vlerësuar se mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive të gjyqtarit relator, por për shkaqe të natyrës objektive që lidhen me pakësimin e ndjeshëm të numrit të gjyqtarëve, të cilët kanë në shqyrtim një numër shumë të lartë çështjesh gjyqësore *(shih vendimin nr. 15, datë 27.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, pika 25)*.

29. Në këto kushte, Gjykata vëren se kërkuesi e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000.

30. Në vijim, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi, jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe vendimi i Gjykatës së Lartë për kërkesën e tij për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm mban datën 27.5.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur fillimisht në Gjykatë në datën 23.6.2022, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

31. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se, në thelb, objekt i ankimit kushtetues individual është tejzgjatja e gjykimit që lidhet me kërkesën e kërkuesit për marrjen e masave nga organet shtetërore për ndalimin e cenimit të së drejtës së tij të pronësisë. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka kërkuar konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm për gjykimin e çështjes së tij të themelit nga Gjykata Administrative e Apelit e të kërkesës për shkelje të këtij afati nga Gjykata e Lartë, si dhe urdhërimin e Gjykatës Administrative të Apelit për përshpejtimin e gjykimit të çështjes.

32. Gjykata thekson se kërkesat për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe për përshpejtimin e gjykimit të çështjes janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Në vështrim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata çmon se, pavarësisht se Gjykata Administrative e Apelit e ka marrë në shqyrtim kërkesën, pretendimi për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit në atë gjykatë përfshihet në juridiksionin kushtetues, pasi tejzgjatja mbi 5 vjet e gjykimit në shkallë të dytë mbetet pretendimi thelbësor i kërkuesit. Për rrjedhojë, në vijim, Gjykata do të analizojë bazueshmërinë në themel të kërkesës së kërkuesit për konstatimin e cenimit të

afatit të arsyeshëm, si rrjedhojë e tejzgjatjes së gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit, pavarësisht faktit se kjo gjykatë tashmë e ka marrë në shqyrtim çështjen e kërkuesit[1].

*B. Për themelin e pretendimeve*

*B.1. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm*

33. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, pasi deri në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual çështja e tij ishte ende në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, pavarësisht se kishin kaluar mbi 5 vjet nga data e regjistrimit të saj pranë kësaj gjykate, në shkelje të nenit 48, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 399/2, pika 1, shkronja "a", të KPC-së.

34. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

35. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 3, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

36. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 4.10.2017 dhe është marrë në shqyrtim nga kjo gjykatë në datën 1.2.2023, pra pas 5 vjetësh, 3 muajsh e 29 ditësh. Në përfundim të gjykimit, gjykata ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

37. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka theksuar se neni 48 i ligjit nr. 49/2012 parashikon afatin 30-ditor për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja "a"), që zgjatet edhe me 6 muaj të tjerë në rastin kur çështjet gjyqësore janë ende në proces gjykimi në kohën e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve (neni 109 i ligjit nr. 38/2017).

38. Kërkuesi ka pretenduar se në gjykimin e çështjes nuk janë respektuar afatet ligjore, duke u zgjatur në mënyrë të paarsyeshme. Duke konsideruar afatet ligjore në rastin konkret, Gjykata vlerëson se gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit i ka tejkaluar afatet ligjore, megjithatë kjo Gjykatë në analizën e këtyre lloj pretendimeve analizon tejzgjatjen për kriteret kushtetuese të afateve të arsyeshme.

39. Konkretisht, në jurisprudencën e saj në vlerësimin e kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos: i. sjelljen e kërkuesit; ii. kompleksitetin e çështjes; iii. sjelljen e autoriteteve; iv. si dhe çfarë përbën rrezik për kërkuesin *(shih vendimet nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 34, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese).* Për rrjedhojë, për të vlerësuar kohëzgjatjen e gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit në rastin konkret dhe nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese e procesit të rregullt në këtë aspekt, këto kritere do të analizohen në vijim.

*i. Sjellja e kërkuesit*

40. Në lidhje me këtë kriter, kërkuesi ka pretenduar se nuk është bërë pengesë për gjykimin, si dhe se ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat e tij procedurale për përshpejtimin e çështjes.

41. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes së kërkuesit është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke u analizuar rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale,

[1] Gjyqtarët Elsa Toska, Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahimi i kanë analizuar më vete kërkimet sipas objektit, ndaj dhe për sa i takon kërkesës së kërkuesit për përshpejtimin e gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit dhe urdhërimin e kësaj të fundit të gjykojë çështjen brenda 3 muajve, përderisa në mënyrë të pavarur nga përfundimi i këtij gjykimi kushtetues kjo gjykatë ka marrë në shqyrtim çështjen, me vendimin e datës 1.2.2023, kjo pjesë e kërkimit ka mbetur pa objekt e për rrjedhojë, në lidhje me të, gjykimi duhet të pushohet.

duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të, dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim *(shih vendimet nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 34, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

42. Gjykata vëren se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa për gjykimin e çështjes. Në datën 7.2.2022 i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. Për rrjedhojë, në rastin konkret, Gjykata vlerëson se sjellja e kërkuesit nuk është bërë shkak për vonesat në shqyrtimin e çështjes së tij.

*ii. Kompleksiteti i çështjes*

43. Kërkuesi ka pretenduar se çështja nuk paraqet kompleksitet si për sa i përket marrëdhënies juridike në konflikt, ashtu edhe subjekteve pjesëmarrëse, çka është pranuar edhe nga Gjykata e Lartë *(shih vendimin nr. 15, datë 27.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, faqja 4, pika 18)*. Gjatë shqyrtimit të çështjes nuk ka pasur problematika në lidhje me njoftimet e palëve, rrethana komplekse në lidhje me thirrje të dëshmitarëve, ose dërgim aktesh nga autoritete ose ente të tjera.

44. Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objekti, faktet e kundërshtuara, volumi dhe natyra e provave, lloji dhe ndërthurja e ligjeve të zbatueshme, si dhe numri i palëve pjesëmarrëse në proces. Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjykimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, sepse balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë *(shih vendimet nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

45. Gjykata vëren se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, që rregullohet nga ligji nr. 49/2012. Si palë në gjykimin në shkallë të parë kanë qenë, krahas kërkuesit, IMT-ja, Tiranë dhe Policia Bashkiake, Tiranë, si persona të paditur, si dhe R.Sh. dhe F.Ç., si persona të tretë. Procedurat përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë rezultojnë të kenë zgjatur përafërsisht 2 muaj e gjysmë, ndërsa Gjykata Administrative e Apelit është vënë në lëvizje me ankim të Bashkisë Tiranë ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

46. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se çështja nuk paraqet rrethana të veçanta ose komplekse që mund të justifikojnë vonesat në gjykimin në shkallë të dytë prej 5 vjetësh e 4 muajsh.

*iii. Sjellja e autoriteteve*

47. Kërkuesi ka pretenduar se shkak për cenimin e së drejtës së tij për gjykim brenda një afati të arsyeshëm është bërë sjellja e autoriteteve, të cilët nuk kanë marrë masat e nevojshme për të shmangur tejzgjatjen e afateve të gjykimit. Sipas tij, administrimi i drejtësisë dhe krijimi i kushteve për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm përbën një detyrim të autoriteteve, të cilët kanë dështuar në përmbushjen e përgjegjësive të tyre.

48. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme *(shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

49. Në jurisprudencën e saj në vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave, Gjykata, duke pasur parasysh ndryshimet që solli reforma në sistemin e drejtësisë në vendin tonë dhe efektet e saj, ka theksuar se parashikimi i një reforme të kësaj natyre nuk mund të justifikojë vonesat, pasi shteti është i detyruar të organizojë hyrjen në fuqi dhe zbatimin e masave që shmangin tejzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në pritje. Në këtë drejtim, akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, në rast se ka ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës për të zgjidhur një situatë të tillë. Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga gjykatat për të nxitur përkohësisht përshpejtimin e gjykimit të çështjeve, nëse edhe një zgjidhje e tillë rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të sigurojë miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një

vendim përfundimtar brenda një periudhe të arsyeshme *(shih vendimet nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

50. Për qëllime të shqyrtimit kushtetues të çështjes, Gjykata vlerësoi të merrte informacion nga Gjykata Administrative e Apelit lidhur me ngarkesën e gjyqtarit relator, të cilit i është caktuar për shqyrtim çështja e kërkuesit. Me shkresën nr. 20/1 prot., datë 10.1.2023, Gjykata Administrative e Apelit e ka informuar Gjykatën se çështja ka qenë fillimisht në ngarkim të gjyqtares A.N. dhe pas procedurave të rishortimit, sipas vendimit nr. 17, datë 10.5.2022, të Këshillit të Gjykatës, "Për rishortimin me short të çështjeve", në datën 17.5.2022 i ka kaluar për gjykim gjyqtares R.S., e cila në datën 22.6.2022 është shkarkuar me vendim të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Pas procedurave të shortimit, sipas urdhrave nr. 432 prot., datë 26.7.2022 "Mbi shortimin e çështjeve të gjyqtarit me skemë delegimi" dhe nr. 372 prot., datë 23.6.2022, "Për rishpërndarjen me short të çështjeve të znj. R.S.", në datën 28.7.2022 çështja i ka kaluar për shqyrtim gjyqtarit S.I., i cili ka në ngarkim 3376 çështje dhe aktualisht po gjykon çështje të periudhës janar–mars 2017. Po sipas kësaj gjykate, nga palët kërkuese nuk rezulton të jetë depozituar kërkesë për përshpejtim drejtuar gjyqtarit S.I., në zbatim të vendimit nr. 78, datë 30.5.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit", ndërkohë që çështja është planifikuar për t'u shqyrtuar në dhomë këshillimi në datën 1.2.2023, ora 10:00.

51. Po sipas informacionit të marrë nga Gjykata Administrative e Apelit, Gjykata vëren se seancën e datës 1.2.2023, trupi gjykues i asaj gjykate ka vendosur prishjen e vendimit nr. 3319, datë 26.7.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

52. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata konstaton se në rastin e kërkuesit, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit për ankimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, është marrë pas 5 vjetësh e 4 muajsh, ndonëse ligjvënësi ka parashikuar afate procedurale konkrete në ligjin nr. 49/2012 *(shih paragrafin 37 të vendimit)*.

53. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se edhe pse efektet e reformës në drejtësi nuk përbëjnë argument kushtetues në vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave dhe se situata nuk është në nivelet e duhura të eficiencës dhe efikasitetit të masave të deritanishme të marra nga autoritetet që mund të çonin në evitimin e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore, duket se KLGJ-ja ka marrë masa konkrete përmes përcaktimit të kalendarit të çështjeve në gjykatën e apelit. Kështu, ndonëse sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata Administrative e Apelit gjyqtari relator po shqyrton çështje të periudhës janar – mars 2017 dhe ka pranuar për gjykim 25 kërkesa për përshpejtim, ai ka marrë në shqyrtim me përparësi ankimin e Bashkisë Tiranë, të regjistruar në datën 4.10.2017. Pra, edhe pse gjyqtari relator ka një kalendar kohor mbi bazën e të cilit cakton shqyrtimin e çështjeve, Gjykata konstaton se ai e ka shqyrtuar me përparësi çështjen konkrete të regjistruar në muajin tetor 2017, ndërkohë që po shqyrton çështje të periudhës janar – mars 2017.

54. Në këtë drejtim, Gjykata çmon se pavarësisht masave të ndërmarra nga Gjykata Administrative e Apelit, në raport me ngarkesën totale të kësaj gjykate prej 21.166 çështjesh, ngarkesën e gjyqtarit relator prej 3.377 çështjesh dhe 25 kërkesave të këtij të fundit për përshpejtimin e gjykimeve të pranuara *(shih shkresat nr. 115/1 prot., datë 26.1.2023 dhe nr. 20/1 prot., datë 10.1.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit)*, në rastin konkret edhe Gjykata Administrative e Apelit ka pasur ndikimin e saj në tejzgjatjen e çështjes.

*iv. Çfarë përbën rrezik për kërkuesin*

55. Kërkuesi ka pretenduar se tejzgjatja e gjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit i ka cenuar atij të drejtën e pronës në drejtim të gëzimit, posedimit dhe disponimit të saj. Interesi i tij në mbrojtjen e kësaj të drejte vazhdon, pasi prona vijon të jetë e rrethuar nga persona jopronarë.

56. Kriteri *"interesi i kërkuesit dhe rreziku që passjell tejzgjatja e procedurave për të"* përbën një aspekt të rëndësishëm të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit, çka është pranuar edhe nga kjo Gjykatë që përpara ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016, kur ajo kontrollonte standardet e kohëzgjatjes së paarsyeshme dhe jepte vendime deklarative në këtë aspekt të procesit *(shih vendimet nr. 56, datë 21.7.2015; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese)*. Po kështu, edhe me vendime të fazës deri kur u bënë të zbatueshme dispozitat e

KPC-së për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, ku kjo Gjykatë vetëm mund të konstatonte shkeljen, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, ajo ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos sjelljen e kërkuesit dhe rrezikun që passjell për të kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit, kompleksitetin e çështjes, si dhe sjelljen e autoriteteve (*shih vendimin nr. 16, datë 16.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese).*

57. Sipas jurisprudencës kushtetuese disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Në këto raste duhet të merret parasysh ajo çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuesit në procesin gjyqësor, pra rëndësia për kërkuesin e së drejtës objekt gjykimi. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë", siç janë ato të kujdestarisë, marrëdhëniet e punës, lipset të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë *(shih vendimin nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*, të cilat duhet të mbahen në konsideratë gjatë gjykimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

58. Kjo përqasje e Gjykatës është në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila ka theksuar se për disa çështje ka interes veçanërisht të lartë nisur nga interesi i kërkuesit. Konkretisht, të tilla çështje janë ato që kanë të bëjnë me: mosmarrëveshjet familjare; vërtetimin e amësisë ose atësisë; viktimat e aksidenteve rrugore, të dhunës penale ose dhunës policore; punësimin ose sigurimet shoqërore; heqjen e lejes për të ushtruar profesionin; qëndrimin e të akuzuarve në paraburgim; çështjet e personave që vuajnë nga sëmundje të pashërueshme; procedurat e kompensimit për dëmtime të shëndetit, në veçanti kur ekziston mundësia që kërkuesi të ndërrojë jetë deri në përfundim të procedurave; mosmarrëveshjet familjare për fëmijët; statusin martesor dhe heqjen ose rivendosjen e aftësisë juridike; çështjet e iniciuara nga të burgosurit për kushte të burgimit, të tilla që cenojnë nenin 3 të KEDNJ-së, të cilat janë edhe më urgjente *(shih vendimet e GJEDNJ-së për çështjet Ebru dhe Tayfun Engin Colak kundër Turqisë, datë 30.5.2006, §§ 74–75; Angelova kundër Rusisë, datë 13.12.2007, §§ 41 dhe 48; Cunha Martins Da Silva Couto kundër Partugalisë, datë 30.4.2015; V.K. kundër Kroacisë, datë 27.11.2012; Veliyev kundër Rusisë, datë 24.6.2010, §§ 173 dhe 178; Intiba kundër Turqisë, datë 24.5.2005, §§ 52–55).*

59. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se në zbatim të parimit *minimis non curat praetor*, që pretendimet për cenimin e një të drejte të merren në shqyrtim prej saj, duhet të arrihet një nivel minimal rrezikshmërie. Përcaktimi i këtij niveli minimal është relativ dhe varet nga rrethanat e çështjes konkrete *(shih vendimin nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

60. Për sa i përket vlerësimit se çfarë përbën rrezik për kërkuesin, në përfundim të diskutimeve, në zbatim të nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

61. Lidhur me kriterin se çfarë rrezikon kërkuesi, sipas njërit qëndrim, kërkesa duhet pranuar, pasi çështja ka të bëjë me të drejtën e pronës, për rrjedhojë është e një natyre të tillë që interesi i kërkuesit rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore.[2]

62. Ndërsa, sipas qëndrimit tjetër, kërkesa duhet rrëzuar, pasi, në thelb, pretendimet kanë të bëjnë me kryerjen nga organet shtetërore të veprimeve për heqjen e rrethimit të bërë pronës së tij nga persona të tretë, pra për çështje të natyrës administrative, që për nga natyra e saj nuk kërkon të trajtohet më me përparësi se çështje të tjera, sipas kalendarit të shqyrtimit të çështjeve. Për më tepër, siç rezultoi gjatë gjykimit, Gjykata Administrative e Apelit e ka shqyrtuar tashmë çështjen, duke e kthyer për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë. Në këtë kuptim, interesi i kërkuesit nuk rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore.[3]

63. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa e kërkuesit konsiderohet e rrëzuar.

[2] Votuan për pranimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja dhe Sandër Beci.

[3] Votuan për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm gjyqtarët Elsa Toska dhe Genti Ibrahimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 133, pika 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.2.2023

Shpallur më 17.3.2023

**Kryesuese:** Marsida Xhaferllari (kundër)

**Anëtarë:** Sonila Bejtja Fiona Papajorgji, Genti Ibrahimi, Sandër Beci, Elsa Toska

**Anëtarë kundër:** Ilir Toska, Marjana Semini

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 13 (A) 2022 të Regjistrit Themeltar, që i përket kërkuesit Agron Bajri, me objekt: "*Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm për çështjen administrative nr. 31116-05015-86-2017, të regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 4.10.2017 dhe përshpejtimi i procedurave për shqyrtimin e saj. Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm për çështjen gjyqësore të regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 15 regjistri dhe shfuqizimi i vendimit 15, datë 27.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Urdhërimin e Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar brenda 3 muajve çështjen gjyqësore nr. 31116-05015-86-2017 të regjistruar më 4.10.2017 pranë kësaj gjykate*", ne, gjyqtarët në pakicë, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica për sa i përket zgjidhjes së kësaj çështjeje, pasi vlerësojmë se duhet të ishte vendosur pushimi i gjykimit të saj në Gjykatën Kushtetuese.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuesi ka vënë në lëvizje një proces gjyqësor për detyrimin e organeve publike, IMT-ja, Tiranë dhe Policia Bashkiake, Tiranë, të kryejnë veprimin administrativ të prishjes së rrethimit të paligjshëm (me tel) të pronës së tij prej dy individëve. Me vendimin nr. 3319 (3380), datë 26.7.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e padisë. Mbi bazën e ankimit të Bashkisë Tiranë, çështja e kërkuesit është regjistruar për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 4.10.2017. Me kërkesën e datës 7.2.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit dhe përshpejtimin e procedurave, duke parashtruar se çështja e tij nuk ishte përfunduar së shqyrtuari në shkallën e dytë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 15, datë 27.5.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se kohëzgjatja e gjykimit në shkallë të dytë ishte objektive për shkak të pakësimit të ndjeshëm të numrit të gjyqtarëve, të cilët kanë në shqyrtim një numër shumë të lartë çështjesh gjyqësore.

3. Në datat 23.6.2022 dhe 31.8.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të themelit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit dhe përshpejtimin e shqyrtimit të saj nga ajo gjykatë, konstatimin e cenimit të kësaj të drejte edhe nga Gjykata e Lartë, si edhe shfuqizimin e vendimit nr. 15, datë 27.5.2022 të Kolegjit Administrativ të asaj gjykate.

4. Gjatë gjykimit kushtetues të kësaj çështjeje, Gjykata Administrative e Apelit ka informuar Gjykatën, ndër të tjera, se ajo po shqyrtonte çështjet e regjistruara në periudhën janar–mars 2017, ndërsa çështja e kërkuesit ishte regjistruar në tetor 2017. Gjithashtu, ajo ka informuar se kërkuesi nuk kishte paraqitur kërkesë për përshpejtimin e gjykimit të çështjes në shkallë të dytë, sipas nenit 460, pika 3, të KPC-së dhe vendimit nr. 78, datë 30.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit", megjithatë çështja e kërkuesit (duke marrë shkak nga zhvillimi i gjykimit kushtetues) ishte planifikuar për t'u shqyrtuar në dhomë këshillimi në datën 1.2.2023, ora 10:00. Në këtë datë, Gjykata Administrative e Apelit e ka shqyrtuar çështjen në themel, duke prishur vendimin nr. 3319 (3380), datë 26.7.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthyer çështjen për rigjykim në po atë gjykatë. Me fjalë të tjera, Gjykata Kushtetuese në seancën e datës 16.2.2023 ka konstatuar se gjykimi i çështjes së kërkuesit në shkallë të dytë kishte përfunduar.

5. Edhe pse në prani të këtij fakti, shumica ka vijuar me shqyrtimin e kësaj kërkese, në lidhje me bazueshmërinë në themel të pretendimeve të kërkuesit dhe në përfundim ka vendosur rrëzimin e saj. Sipas saj, në thelb, objekt i ankimit kushtetues individual është tejzgjatja e gjykimit të kërkesës për marrjen e masave nga organet shtetërore për ndalimin e cenimit të së drejtës së pronësisë së kërkuesit dhe duke qenë se kërkesat për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe për përshpejtimin e gjykimit të çështjes janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, pretendimi për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit përfshihet në juridiksionin kushtetues (*shih paragrafët 31 dhe 32 të vendimit*). Më tej, shumica ka analizuar pretendimin për cenimin e së drejtës për proces të rregullt, në drejtim të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, dhe e ka vlerësuar atë në kuptim të kritereve të përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese. Sipas saj: (i) sjellja e kërkuesit nuk është bërë shkak për vonesat (*shih paragrafin 42 të vendimit*); (ii) çështja nuk paraqitet komplekse që të mund të justifikohet vonesa e gjykimit në shkallë të dytë prej 5 vjetësh e 4 muajsh (*shih paragrafin 46 të vendimit*); (iii) pavarësisht masave të ndërmarra nga Gjykata Administrative e Apelit, në raport me ngarkesën totale të kësaj gjykate, ngarkesën e gjyqtarit relator dhe kërkesave të këtij të fundit për përshpejtimin e gjykimeve të pranuara, edhe ajo gjykatë ka pasur ndikimin e saj në tejzgjatjen e çështjes (*shih paragrafin 54 të vendimit*); (iv) lidhur me kriterin e interesit/së drejtës që i rrezikohet kërkuesit, në përfundim të diskutimeve nuk është arritur numri i kërkuar i votave për vendimmarrje (*shih paragrafin 60 të vendimit*).

6. Në vlerësimin tonë, si gjyqtarë në pakicë, në çështjen konkrete ishte me rëndësi që Gjykata të ndalej në analizën e mjeteve juridike në dispozicion të kërkuesit dhe më konkretisht të efektivitetit të tyre në praktikë, nën dritën edhe të zhvillimeve të reja që kanë ndodhur gjatë kohës që kjo çështje ishte në pritje të shqyrtohej në këtë Gjykatë, si dhe të rrethanave të konstatuara gjatë këtij gjykimi kushtetues.

7. Dispozitat e reja procedurale, nenet 399/1 e vijuese të KPC-së, kanë përcaktuar se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), çfarë do të konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4* dhe *399/6*), rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*) etj. Sipas nenit 399/3 të KPC-së, shpërblim i drejtë konsiderohet njohja e shkeljes, masat e marra për përshpejtimin e procedurave dhe/ose shpërblimi i dëmit, i përcaktuar në vlerë monetare në nenin 399/10 të këtij kodi.

8. Pas hyrjes në fuqi të këtyre dispozitave ligjore dhe fillimit të zbatimit të mjeteve të reja juridike, Gjykata është ndalur disa herë në shqyrtimin e efektivitetit të tyre. Ajo ka vlerësuar se legjislacioni parashikon tashmë një mjet juridik ankimi efektiv, i cili garanton si përshpejtimin e procesit gjyqësor, ashtu edhe dëmshpërblimin, pra ofron një rezultat konkret në drejtim të rivendosjes të së drejtës së shkelur për proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme ligjore (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 15.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 80, datë 18.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore efektive me qëllim që individit t'i garantohet mbrojtja efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm ose edhe për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 16, datë 16.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Duke e parë në këtë këndvështrim, në vlerësimin tonë ka dy lloj mjetesh juridike në dispozicion të individit në lidhje me kohëzgjatjen e paarsyeshme të çështjes: 1) mjetet përshpejtuese/parandaluese; dhe 2) mjetet korrigjuese/dëmshpërblyese. Qëllimi i këtyre mjeteve është që të garantojnë të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në dy plane: (i) parandalimi i shkeljes ose i vazhdimit të saj, në kuptimin që në një çështje konkrete, e cila është duke zgjatur në kohë, të urdhërohet përshpejtimi i procedurave, në mënyrë që individit të mos i cenohet e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm: (ii) rivendosja e së drejtës së shkelur kur konstatohet shkelje e afatit të arsyeshëm, nëpërmjet përfundimit të procedurave sa më shpejt të jetë e mundur dhe eventualisht, caktimit të një shpërblimi të drejtë.

10. Këto mjete juridike janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën në atë mënyrë që, në rast se mjetet parandaluese nuk kanë qenë efektive, pra nuk kanë arritur të sjellin përshpejtimin e procedurave dhe parandalimin e shkeljes ose vijimit të saj, ato i lënë

vend aplikimit të mjeteve korrigjuese të kësaj vonese.

11. Në kuptim të sa më sipër, ankimi kushtetues për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, duke respektuar edhe rolin subsidiar të gjykatave të zakonshme, duhet të ketë në objektin e tij vlerësimin e efektivitetit në praktikë të mjeteve procedurale të parashikuara nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së. Në vlerësimin e efektivitetit në praktikë të këtij mjeti juridik, Gjykata analizon nëse ai është real, i drejtpërdrejtë, konkret dhe i shpejtë në kohë, pra që ai nuk është një mundësi e tërthortë për kërkuesin. Kur kërkesa për përshpejtimin e procedurave nuk i ka shërbyer qëllimit të saj – përshpejtimit të procedurave ose parandalimit të tejzgjatjes së paarsyeshme të shqyrtimit të çështjes, atëherë ky mjet juridik nuk ka qenë efektiv në praktikë (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Është pikërisht rasti kur konstatohet me vendim të formës së prerë se ky mjet nuk ka qenë efektiv, që konsiderohet se kërkuesit i lind e drejta që të kërkojë kompensim për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procedurave.

12. Në këtë pikëpamje, duke mbajtur në konsideratë që në rastin konkret në shqyrtim, me paraqitjen e kërkesës për përshpejtim, në kuptim të neneve 399/1 e vijuese të KPC-së, gjykimi në shkallë të dytë është përshpejtuar dhe ka përfunduar shqyrtimi i çështjes së kërkuesit, pra i procedurës gjyqësore për të cilën ai ka vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, vlerësojmë se mjeti juridik i përdorur ka treguar të jetë efektiv në praktikë, pasi e ka arritur tashmë qëllimin e tij përshpejtues/parandalues. Duke qenë se ky mjet ka sjellë pasojën e pritshme në drejtim të përshpejtimit të procedurave, në vlerësimin tonë gjykimi i kësaj çështjeje duhej të ishte pushuar.

13. Edhe vetë KPC-ja ka parashikuar pushimin e gjykimit të këtyre kërkesave për këtë shkak. Më konkretisht, sipas pikës 3 të nenit 399/7 të KPC-së, në rast se gjatë shqyrtimit të kërkesës organi që po kryen veprimet ndërmerr hapat që po kërkohen nga pala, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, pushon shqyrtimi i kërkesës. Në këtë rast, në kuptim të pikës 2 të nenit 1 të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit për çështje që nuk rregullohen nga ky ligj ose nga Rregullorja e Gjykatës bëhen të zbatueshme dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, në konsideratë të natyrës ligjore të çështjes, kishte vend për zbatimin e nenit 299, shkronja "c", të KPC-së, sipas të cilit gjykata vendos pushimin e gjykimit kur ai nuk mund të vazhdojë.

14. Nga ana tjetër, vlerësojmë me rëndësi të vëmë në dukje edhe një aspekt tjetër të këtyre lloj gjykimesh që kanë të bëjnë më sjelljen e kërkuesit. Kjo, sepse jo vetëm këto mjete juridike janë të reja, por ato janë testuar në lidhje me efektivitetin e tyre në një situatë jo të zakonshme të funksionimit të sistemit gjyqësor dhe zhvillimit të procedurave gjyqësore. Po kaq e re është edhe jurisprudenca e Gjykatës në drejtim të vlerësimit të efektivitetit të këtyre mjeteve juridike.

15. Sipas shumicës, në lidhje me kriterin e sjelljes së kërkuesit është vlerësuar se ai ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa për gjykimin e çështjes dhe ai i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. Për rrjedhojë, në rastin konkret është vlerësuar se sjellja e kërkuesit nuk është bërë shkak për vonesat në shqyrtimin e çështjes së tij (*shih paragrafin 42 të vendimit*).

16. Sipas GJEDNJ-së, sjellja e kërkuesve përbën një fakt objektiv që nuk mund t'i atribuohet shtetit dhe që duhet të merret parasysh me qëllimin për të përcaktuar nëse është tejkaluar ose jo afati i arsyeshëm, sipas nenit 6 § 1 (*shih Poiss kundër Austrisë , § 57; Wiesinger kundër Austrisë, 1991, § 57; Humen kundër Polonisë [GC], 1999, § 66*). Ne i qëndrojmë jurisprudencës së Gjykatës se te kohëzgjatja e përgjithshme e gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, sepse barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Por vlerësojmë, gjithashtu, se mjetet juridike të parashikuara nga dispozitat procedurale, dhe nuk i referohemi këtu thjesht kërkesës për konstatimin e cenimit dhe shpërblimin e drejtë në kuptim të neneve 399/1 e vijuese të KPC-së, për shkak të natyrës dhe qëllimit të tyre kërkojnë edhe që vetë individi të tregojë përkushtimin e duhur, në kohën e duhur. Në këtë pikë duhet evidentuar se para se të bëhen të disponueshme këto mjete juridike (kupto kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm), palët në procesin gjyqësor kanë edhe

mjete të tjera ligjore në dispozicion me qëllim përshpejtimin e procesit dhe eliminimin e vonesave. Në rastin konkret, konstatohet se kërkuesi nuk ka paraqitur, gjatë kohës që çështja e tij ka qenë në pritje të shqyrtohet në gjykatën e apelit, ndonjë kërkesë për përshpejtimin e çështjes sipas nenit 460, pika 3, të KPC, në zbatim të vendimit nr. 78, datë 30.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit" (*shih paragrafin 50 të vendimit*), por në vitin 2022 i është drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave dhe, më pas, edhe Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual. Në vlerësimin tonë do të ishte me rëndësi për këtë lloj gjykimi, veçanërisht në aspektin e situatës aktuale të zhvillimit të proceseve gjyqësore, të kishte një analizë nga ana e Gjykatës të sjelljes së kërkuesit për sa i përket përdorimit prej tij të instrumenteve procedurale që parashikon KPC-ja përpara se për individin të bëhen të disponueshme mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së.

17. Në përfundim, vlerësojmë se për sa kohë që në kohën e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata Administrative e Apelit, ku pretendohet se ka ndodhur shkelja, e ka shqyrtuar në themel çështjen e kërkuesit dhe ka dhënë vendim në lidhje me të, pavarësisht kohëzgjatjes së këtij procesi, mjeti procedural me natyrë përshpejtuese/parandaluese e ka përmbushur qëllimin që synon ai, ashtu si edhe vetë ankimi kushtetues individual.

18. Për sa kemi parashtruar më sipër, jemi të qëndrimit se Gjykata nuk duhet të kishte vijuar me shqyrtimin në themel të kësaj çështjeje, por duhej të kishte vendosur pushimin e gjykimit të saj.

**Anëtarë:** Marjana Semini, Ilir Toska, Marsida Xhaferllari

**VENDIM**
**Nr. 10, datë 3.3.2023**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME FIER SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR
RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 3.3.2023 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit 'Për licencimin e shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a.'",

KONSTATON SE:

1. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a., me shkresën nr. 680 prot. datë 10.2.2023, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të shoqërisë rajonale UK Fier sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, "Për politikat kombëtare për riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura" (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a., me (NUIS M23315402G) është themeluar më datë 8.9.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51% dhe bashkitë Fier me 33.99 %, Patos me 5.21%, Roskovec me 4.31 % dhe Mallakastër me 5.49%;

b) shoqëria rajonale UK Fier sh.a. ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 225 721 banorë të bashkive Fier, Patos, Roskovec, Mallakastër;

c) drejtues teknik i shoqërisë z. Artur Baxhia është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë së Minierave në vitin 1995 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë rajonale UK Fier sh.a., të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht, në lidhje me kufizimin e tregjeve;

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë rajonale UK Fier rekomandon:

a) Shoqëria rajonale UK Fier, duhet të pajiset me akt miratimet higjieno-sanitare të rinovuara/azhurnuara për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale UK Fier.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë rajonale UK Fier sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a., me (NUIS M23315402G), në kategoritë:

a) kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura;

2. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor: z. Petrit Kanani;

b) drejtues teknik: z. Artur Baxhia.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a. janë bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Mallakastër.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

7. Vendimi i KKRR-së nr. 120, datë 20.10.2020, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a.", shfuqizohet. Vendimi i KKRR-së nr. 429, datë 11.11.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Roskovec sh.a.", shfuqizohet. Vendimi i KKRR-së nr. 37, datë 11.7.2019, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Mallakastër sh.a.", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Ndriçim Shani**

**VENDIM**
**Nr. 11, datë 3.3.2023**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME BERAT SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 3.3.2023 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit 'Për licencimin e shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Berat sh.a.'",

KONSTATON SE:

1. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Berat sh.a., me shkresën nr. 188 prot. datë 21.2.2023, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të shoqërisë rajonale UK Berat sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, "Për politikat kombëtare për riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura" (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Berat sh.a. (NUIS M23511002O) është themeluar më datë 4.11.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51% dhe bashkitë Berat me 23.01%, Dimal me 5.39%, Poliçan me 3.58%, Kuçovë me 12.32%, Skrapar me 4.7%;

b) shoqëria rajonale UK Berat sh.a. ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 155 928 banorë të bashkive Berat, Skrapar, Poliçan, Dimal, Kuçovë;

c) drejtues teknik i shoqërisë znj. Evis Allajbe është diplomuar në Universitetin Politeknik në Inxhinieri hidroteknike në vitin 2005 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë rajonale UK Berat sh.a., të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht, në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë rajonale UK Berat sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Berat sh.a., me (NUIS M23511002O), në kategoritë:

a) kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura;

2. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Berat sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor: Pelivan Sinaj;

b) drejtues teknik: Evis Allajbe.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Berat sh.a. janë bashkitë Berat, Skrapar, Poliçan, Dimal, Kuçovë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Berat sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Berat sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

7. Vendimi i KKRR-së nr. 143, datë 27.11.2020, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Dimal sh.a.", shfuqizohet. Vendimi i KKRR-së nr. 318, datë 20.8.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Skrapar sh.a.", shfuqizohet. Vendimi i KKRR-së nr. 475, datë 9.12.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Poliçan sh.a.", shfuqizohet. Vendimi i KKRR-së nr. 518, datë 21.12.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Berat–Kuçovë sh.a.", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Ndriçim Shani**

**VENDIM**
**Nr. 12, datë 3.3.2023**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME LUSHNJË SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR
RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 3.3.2023 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit 'Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a.'",

KONSTATON SE:

1. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a., me shkresën nr. 174 prot., datë 21.2.2023, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të shoqërisë rajonale UK Lushnjë sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, "Për politikat kombëtare për riorganizimin e

Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura" (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. (NUIS M24606401K) është themeluar më datë 3.10.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51% dhe bashkitë Lushnjë me 37.79%, Divjakë me 11.21%;

b) shoqëria rajonale UK Lushnje sh.a ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 112 272 banorë të bashkive Lushnjë, Divjakë;

c) drejtues teknik i shoqërisë Klajdi Myzeqari është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës në Inxhinieri, "Hidroteknikë", në vitin 2014 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë rajonale UK Lushnjë sh.a., të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë rajonale UK Lushnjë sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a., me (NUIS M24606401K), në kategoritë:

a) kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lushnje sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor: Klaidi Shkurti;

b) drejtues teknik: Klajdi Myzeqari.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lushnje sh.a. janë bashkitë Lushnjë dhe Divjakë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lushnje sh.a., për marrjen e këtij vendimi.

7. Vendimi i KKRR-së nr. 281, datë 24.6.2022, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a.", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Ndriçim Shani**

**VENDIM**
**Nr. 13, datë 3.3.2023**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR Nr. 431, datë 11.11.2021, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME SHKODËR"**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë

veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR
RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 3.3.2023 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit 'Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 431, datë 11.11.2021, 'Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Shkodër'",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Shkodër (UK Shkodër), me shkresën nr. 328 prot., datë 21.2.2023, me lëndë: "Kërkesë për ndryshimin e drejtuesit ligjor të shoqërisë", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Shkodër për rinovim licence, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Shkodër me vendimin nr. 431, datë 11.11.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Shkodër, me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Shkodër sh.a., z. Arvit Bushati, ka përfunduar master shkencor në "Drejtësi civile dhe tregtare".

5. ERRU, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Shkodër sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Shkodër është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 2 të vendimit të KKRR-së nr. nr. 431, datë 11.11.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Shkodër", bëhen këto ndryshime:

"Drejtues ligjor: z. Arvit Bushati."

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Ndriçim Shani**

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 46
Datë: 2023/03/21 13:08:31
726360f6-903c-4237-a7d1-af270e166cfa

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë